



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Sistemet e pagesave dhe të shlyerjes në Kosovë

S h k u r t 2 0 1 7

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Sistemet e pagesave dhe të shlyerjes në Kosovë

(Përmbledhje informative rreth sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes në Republikën e Kosovës)

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org

SHKURTESAT:

AIMK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
ABPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
BIS	Banka për Shlyerje Ndërkombëtare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CPSS	Komiteti për Sistemet e Pagesave dhe të Shlyerjes
ECB	Banka Qendrore e Evropës
IFLEX	Sistemi Qendror i Kontabilitetit të BQK-së (Flex Cube)
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KKPN	Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare
RTGS	Real Time Gross Settlement, (Shlyerja bruto në kohë reale)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SKP	Sistemi Kombëtar i Pagesave
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SHSK	Shoqata e Sigurimeve të Kosovës

PËRMBAJTJA

HYRJE	05
1. Aspekti institucional	06
1.1. Korniza e përgjithshme institucionale	06
1.2. Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	07
1.2.1. Parimet e përgjithshme	07
1.2.2. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave	08
1.2.3. Roli operacional i BQK-së	09
1.2.4. Strategjia e zhvillimit të SP	12
1.2.5. Bashkëpunimi me institucione të tjera	12
1.3. Roli i organeve të tjera publike dhe private	13
1.3.1. Shoqata e Bankave të Kosovës	13
1.3.2. Shoqata e Sigurimeve të Kosovës	13
1.3.3. Asociacioni i institucioneve mikrofinanciare të Kosovës	13
1.4. Ndërmjetësit financiarë që ofrojnë shërbime pagesash në Kosovë	14
1.4.1. Bankat	14
1.4.2. Institucionet mikrofinanciare	14
1.4.3. Agjencionet për transfer parash	14
2. Instrumentet e pagesave në Kosovë	14
2.1. Pagesat me para të gatshme	14
2.2. Pagesat me para jo të gatshme	15
2.2.1. Transferet e kreditit	15
2.2.2. Çeqet	16
2.2.3. Kartelat me funksion pagese	16
2.2.4. Debitimi Direkt	16
2.2.5. E-Banking	17
2.3. Zhvillimet e reja	17
3. Sistemi i kliringut dhe shlyerjes	18
3.1. Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar	18

3.1.1. Rregullat dhe procedurat	19
3.1.2. Pjesëmarrja në SEKN	20
3.1.3. Llojet e transaksioneve të SEKN-së.....	20
3.1.4. Orari i punës	22
3.1.5. Tarifat dhe çmimet	22
3.2. Informata statistikore	23

Hyrje

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), BQK-ja është ekskluzivisht përgjegjëse për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë¹. Po ashtu, Banka Qendrore është e autorizuar të organizojë, të posedojë, të marrë pjesë dhe të operojë sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë.

Objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxitë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Në nenin 21 të Ligjit për BQK-në ceket se *“Banka Qendrore mund të ofrojë shërbime, duke përfshirë kredi brenda-ditore të kolateralizuara me letra me vlerë të negociueshme të Qeverisë, për sisteme të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe për pjesëmarrësit në to për të garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të tilla”*.

Themelimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) në vitin 2001, si sistemi i parë i pagesave ndërbankare ishte një arritje e madhe drejt lehtësimit të operacioneve të pagesave ndërbankare. SEKN-ja si sistem i vetëm i pagesave në vend i zhvilluar dhe përmirësuar gradualisht gjatë viteve, ishte një sistem hibrid i pagesave ndërbankare, i cili procedon një sërë instrumentesh të pagesave me vlera të vogla dhe të mëdha, pagesat urgjente (pagesat prioritare).

Duke filluar nga data 1 korrik 2016, sistemi ekzistues i pagesave në BQK është zëvendësuar me një sistem të ri i cili është projektuar sipas standardeve të fundit të fushës së sistemit të pagesave. Implementimi i këtij sistemi është një ndër hapat kryesor që BQK-ja ka ndërmarrë për forcimin e stabilitetit dhe rritjen e efikasitetit të sektorit financiar dhe atij bankar në veçanti.

Sistemi i ri i pagesave ndërbankare, i quajtur ATS (automatic transfer system/sistemi automatik i transferit) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (real time gross settlement/shlyerjet bruto në kohë reale), i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (automatic clearing house/sistem automatik i kliringut) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël.

¹ Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 22.

Në kuadër të BQK-së, Departamenti i Sistemeve të Pagesave (DSP) është përgjegjës për operimin dhe mbikëqyrjen e SPN-së.

Në fushën e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka filluar të zbatojë funksionin e saj, që është në linjë me kërkesat dhe standardet e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe me Parimet për Infrastrukturën e Tregut Financiar (angl. Financial Market Infrastructure) të Bankës Ndërkombëtare për Shlyerje (angl. Bank For International Settlement). Në shtator të vitit 2016 Bordi Ekzekutiv i BQK-së ka aprovuar Politikës për Mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave, përmes së cilës përcaktohen parimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të cilët operojnë në Republikën e Kosovës.

Sa i përket instrumenteve të pagesave, pagesat në para të gatshme vazhdojnë të përdoren shumë në krahasim me pagesat pa para të gatshme. Megjithatë, numri i pagesave pa para të gatshme është vazhdimisht në rritje. Vlera dhe numri i pagesave me kartela është rritur veçanërisht në mënyrë të konsiderueshme në vitet e fundit.

1. Aspekti institucional

1.1. Korniza e përgjithshme institucionale

Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligji për Sistemin e Pagesave paraqesin shtyllën kryesore të kornizës ligjore për sistemin e pagesave në vend.

Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L-209) përcakton kompetencat e BQK-së rreth sistemeve të pagesave, dispozitat e këtij ligji ndër të tjera i japin BQK-së këto detyra specifike: “promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë”. Ligji po ashtu i jep BQK-së të drejtën “të organizojë, të posedojë, të marrë pjesë dhe të operojë sisteme të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë” .

Ligji për Sistemin e Pagesave përcakton:

- rregullat sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave, që ofrojnë shërbime të pagesave dhe licencohen operatorët e sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë nga Banka Qendrore;

- kushtet dhe standardet sipas të cilave mund të ofrohen shërbimet e tilla dhe mund të funksionojnë sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së pagesave, dhe;
- mjetet dhe procedurat sipas të cilave Banka Qendrore i ushtron kompetencat e saj mbikëqyrëse;

Pos dy ligjeve të përmenduara më lartë, funksionimi i sistemit të pagesave është i rregulluar edhe nga një numër i akteve të tjera nënligjore si:

- Rregullore për Sistemin e Pagesave Ndërbankare;
- Rregullore për skemën e Debitimit Direkt;
- Udhëzim për skemën Kos Giro;
- Rregullore për sistemin standard të numrave të llogarive bankare;
- Rregullore për pagesa ndërkombëtare;
- Rregullore për regjistrin e llogarive bankare;
- Rregullore për statistikat e instrumenteve të pagesave;
- Politika për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, etj.

Rregullore për Sistemin e Pagesave Ndërbankare përcakton rregullat dhe procedurave për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Kosovës.

Rregullorja për skemën e debitimit direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar përcakton parimet dhe kërkesat bazë në lidhje me funksionimin e kësaj skeme. Në kuadër të Rregullores përfshihen dispozitat kryesore, që aplikohen për anëtarët e Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) dhe akterët e tjerë të përfshirë në Skemën e Debitimit Direkt.

Rregullorja për sistemin standard të numrave të llogarive bankare përcakton strukturën e numrave të llogarive bankare, marrëdhëniet ndërmjet bankës dhe klientit në lidhje me krijimin, komunikimin dhe përdorimin e numrave të llogarive bankare, si dhe procedurave për kontrollet e vlefshmërisë së numrave të llogarive bankare.

Rregullorja për regjistrin e llogarive bankare përcakton mbledhjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e informatave për poseduesit e llogarive bankare përmes Regjistrin të Poseduesve të Llogarive Bankare.

Rregullorja mbi statistikat e instrumenteve të pagesave rregullon raportimin e statistikave mbi instrumentet e pagesave. Rrjedhimisht, Rregullorja definon statistikat që duhet të raportohen, raportuesit dhe

obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit, raportet statistikore, si dhe konfidencialitetin.

Politika për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave përcaktohen parimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave të cilët operojnë në Republikën e Kosovës. BQK-ja është duke rishikuar në mënyrë të hollësishme kornizën ligjore, me qëllim të zhvillimit dhe miratimit/rishikimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, pasi që kjo është e nevojshme për të sjellë sistemet e pagesave dhe të shlyerjes në Kosovë në përputhje me standardet evropiane dhe praktikrat e tjera ndërkombëtare.

1.2. Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1.2.1. Parimet e përgjithshme

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, u themelua BQK-ja, bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Ligjin nr. 03/L-209) si një institucion i pavarur i cili i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. BQK-ja është pasuese e Autoritet Qendror Bankar të Kosovës (AQBK), e cili ishte themeluar me Rregulloren e UNMK-ut 2006/47, më 24 gusht 2006, si pasuese e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (ABPK). Sipas ligjit të Bankës Qendrore objektivi parësor i BQK-së është “të nxitë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.”

1.2.2. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave

Ligji i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mënyrë të drejtpërdrejtë i jep të drejtën BQK-së të mbikëqyrë sistemet e pagesave në vend. Për të përmbushur këtë rol, BQK-ja ka funksionalizuar Divizionin e mbikëqyrjes dhe analizave të sistemeve të pagesave, në kuadër të Departamentit të Sistemeve të Pagesave. Kjo njësi do të mbikëqyrë sistemet e pagesave në vend.

- Me qëllim të mbikëqyrjes efikase dhe transparente të sistemit kombëtar të pagesave si tërësi dhe të pjesëve të tij relevante, Banka Qendrore: përcakton standardet, rregullat dhe direktivat e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/apo operimin e sistemeve me anë të rregulloreve apo udhëzimeve;
- nxjerrë urdhra, vlerëson dhe siguron zbatimin e standardeve, rregullave dhe direktivave të caktuara nëpërmjet monitorimit në vend dhe jashtë, duke përfshirë vendosjen e kushteve, promovimin e

efikasitetit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të pagesave elektronike, inkurajimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet palëve të interesit.

Në lidhje me fushëveprimin e rolit mbikëqyrës, BQK-ja mbikëqyr të gjitha sistemet e kliringut dhe shlyerjes në Kosovë, duke përfshirë sistemet e pagesave me vlera të vogla, sepse ato janë veçanërisht të rëndësishme në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe besimin e publikut. BQK-ja mbikëqyr gjithashtu operatorët e sistemeve, infrastrukturën teknike dhe ligjore, pjesëmarrësit direkt në sistemet e pagesave, subjektet e licencuara të cilat emetojnë dhe/ose menaxhojnë instrumente të pagesave, si dhe instrumentet e pagesave që përdoren në kontekstin e sistemeve të pagesave.

Banka Qendrore e Kosovës kryen mbikëqyrjen, në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, sipas një procesi tre hapësh: të monitorimit, vlerësimit dhe inicimit të ndryshimeve aty ku është e nevojshme.

Në fazën e monitorimit, BQK-ja grumbullon informacionin e duhur nga operatorët dhe pjesëmarrësit e sistemeve. Pastaj, i vlerëson të dhënat e mbledhura përmes monitorimit mbi bazën e kërkesave të politikave të mbikëqyrjes, rekomandimit dhe standardeve që i ka hartuar qoftë vetë apo në bashkëpunim me bankat qendrore apo autoritetet e tjera. Nëse gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se ekziston nevoja për të inkurajuar ndryshime në karakteristikat e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes të monitoruara, BQK-ja në përputhje me objektivat e mbikëqyrjes mund të kërkojë ndryshime kur është e nevojshme.

Gjatë mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, BQK-ja ka të drejtë të kërkojë që të gjitha palët relevante të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe informatat mbi aktivitetet e palëve në fjalë. BQK-ja ka gjithashtu të drejtë të kryejë inspektime në vend përmes zyrtarëve apo personave të tjerë të autorizuar nga ajo.

Personat të cilët janë subjekte të mbikëqyrjes janë të detyruar t'i sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme dhe të bashkëpunojnë me BQK-në, si dhe të përmbahen nga çdo veprim që mund të pengojë kryerjen e procesit të mbikëqyrjes.

Gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, BQK-ja bashkëpunon në lëmin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave me bankat qendrore në vendet e tjera, si dhe me institucionet mbikëqyrëse financiare.

1.2.3. Roli operacional i Bankës Qendrore të Kosovës

Sistemet e pagesave

BQK-ja operon dhe mbikëqyr një sistem të vetëm pagesash të quajtur Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN) i cili përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement) i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël.

Brenda BQK-së, Departamenti i Sistemeve të Pagesave (DSP) është përgjegjësi kryesor për operimin, mbikëqyrjen dhe veprimet e tjera që lidhen me SPN. DSP-ja është ngarkuar edhe me zhvillimin e mëtejshëm të SPN-së dhe me futjen e sistemeve të reja dhe instrumenteve të pagesave që shihen të nevojshme nga pjesëmarrësit në sistem të pagesave. Disa nga objektivat kryesore të departamentit janë:

- “të nxitë zhvillimin e sistemeve ndërbankare të pagesave në mënyrë që... të rritë fushën e shërbimeve në dispozicion të komunitetit të pagesave” dhe
- “të nxitë përdorimin e pagesave jo në para të gatshme”

Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare

Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare (KKPN) është themeluar për të vendosur rregullat e veprimit, procedurat dhe standardet për sistemin e pagesave dhe mblidhet vazhdimisht për të diskutuar çështjet operationale të pagesave. Anëtarë të KKPN-së janë përfaqësues nga BQK-ja, bankat komerciale dhe institucionet e Qeverisë përmes Thesarit/MF. Departamenti i Sistemeve të Pagesave brenda BQK-së është udhëheqës i këtij Komiteti. Ekziston një frymë e lartë bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve që përdorin SPN, i cili është pranuar mirë nga të gjitha bankat.

Kliringu

Kliringu i pagesave ndërbankare bëhet përmes SPN-së. Të gjitha bankat komerciale janë anëtare të ligjshme në SPN, si dhe me pjesëmarrje të vet BQK-ës (në emër të vet dhe të institucioneve të Qeverisë). Sistemet qendrore të pjesëmarrësve janë të lidhura në mënyrë elektronike me SPN-në. Kliringu i pagesave me vlerë të madhe dhe atyre prioritare kryhet në baza bruto, ndërsa pagesat e tjera në baza neto sipas sesioneve (4 herë gjatë dite).

BQK-ja ka në funksion katër sesione kliringu të SPN-së në ditë për të gjitha llojet e pagesave me vlerë të vogël (deri në 10,000 €) , një në orën 10:00; 13:30, dhe në orën 15:15 dhe i fundit 15:45 (për pagesa me rëndësi të veçantë për likuiditet). Çmimi për një transaksion ndryshon varësisht nga lloji i pagesës dhe sesioni që kryhet kliringu: çmimet janë më të larta për sesionet e paradites, ndërsa më të ulëta për sesionet e pasdites. Pagesat me vlerë të madhe (mbi 10,000 €) dhe ato prioritare klirohen një nga një në baza bruto, jo me vonë se 15 minuta pas pranimit të tyre, nga ora 8:00 deri në ora 15:45.

Shlyerja

Shlyerja kryhet duke përfshirë të dhënat neto të bilanceve nga ACH-ja në RTGS. Shlyerja realizohet në llogarinë individuale dhe të vetme të secilit pjesëmarrës, që mbahet në sistemin e BQK-së. Departamenti i Sistemeve të Pagesave vazhdimisht monitoron procesin e shlyerjes, në veçanti duke shikuar me kujdes që nivelet minimale të rezervës së likuiditetit të mos shkelen. Niveli i detyrueshëm i rezervave për çdo bankë është 10% e bazës së caktuar të depozitave të çdo banke, prej të cilave të paktën gjysma (5%) duhet të mbeten gjithmonë në BQK.

Sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë

Ministria e Financave në bashkëpunim me BQK-në kanë implementuar sistemin e letrave me vlerë dhe ka filluar emetimi i letrave me vlerë në emër të Qeverisë që nga janari 2012.

Në dhjetor të vitit 2009, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Borxhet Publike (Ligji nr. 03/L – 175), i cili i jep Republikës së Kosovës të drejtën për të huazuar para; për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e borxheve të saj shtetërore.

BQK-ja ka implementuar një sistem të tregtimit, depozitimit dhe të shlyerjes së letrave me vlerë për të ofruar funksionimin e duhur në përkrahje të Thesarit dhe veprimtarisë së tij në lidhje me borxhet vendore. Ky sistem ndërlidhet me një sistem ankandi për veprimtaritë e tregjeve primare (që bëjnë emetimin e letrave me vlerë), si dhe lidhet ngushtë me sistemin e pagesave për këto qëllime (i) zbatimin e veprimtarive SHKP (shpërndarje kundrejt pagesës) për shlyerjen e të gjitha transaksioneve të letrave me vlerë dhe (ii) për të përkrahur (kolateralizuar) veprimtaritë që ndihmojnë likuiditetin brenda ditës në sistemin e pagesave të BQK-së.

1.2.4. Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave (SKP)

Duke pasur parasysh rëndësinë e sistemit të pagesave për ekonominë e një vendi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me akterë të tjerë ka hyrë në një proces strategjik për të modernizuar Sistemin Kombëtar të Pagesave në Kosovë. Vizioni i Sistemit Kombëtar të Pagesave në të Ardhmen (Vizioni), dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Vizionit të Sistemit Kombëtar të Pagesave (Plani i Veprimit), të cilët bashkërisht përbëjnë strategjinë e zhvillimit të SKP-së, u miratuan nga Bordi drejtues i BQK-së më 11 shtator 2009. Departamenti i Sistemeve të Pagesave (DSP) ka rol koordinues për zbatimin e strategjisë.

Strategjia e zhvillimit të SKP-së ka nëntë shtylla: I. Korniza ligjore; II. Pagesat me vlerë të madhe dhe ato urgjente; III. Sistemi i pagesave me vlera të vogla; IV. Transaksionet qeveritare; V. Letrat me vlerë, depozitimi, kliringu dhe shlyerja; VI. Tregu monetar; VII. Dërgesat nga jashtë (remitencat); VIII. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave; IX. Bashkëpunimi (Këshilli Kombëtar i Pagesave - KKP).

Nga të gjitha këto projekte individuale të parapara në kuadër të strategjisë së zhvillimit të SKP-së, projekti më madhor është implementimi i sistemit për shlyerje të pagesave në kohë reale (RTGS). Ky sistem do të jetë shtylla e sistemit kombëtar të pagesave.

Vlen të theksohet në veçanti se strategjia për zhvillimin e SKP-së është promovuar në mesin e të gjitha palëve relevante, si dhe të publikut të gjerë. Ajo është mirëpritur dhe përkrahur nga të gjitha palët e në veçanti nga komuniteti financiar në Kosovë, ku në përgjithësi ekziston një përkushtim i madh për zhvillimin e një SKP-je efikase dhe të sigurt.

1.2.5. Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP)

Këshilli Kombëtar i Pagesave është themeluar në vitin 2009. Ai përbëhet nga përfaqësues nga BQK-ja, SHBK-ja dhe bankat komerciale të përfaqësuara në Bordin drejtues të SHBK-së si dhe Thesari-MF. Ky këshill ka një strukturë formale me Guvernatorin/Zëvendësguvernatorin e BQK-së si kryesues dhe sekretariati i tij gjithashtu sigurohet nga BQK-ja. Përfaqësuesit e caktuar të akterëve janë kryeshefat ekzekutivë (drejtorët menaxhues) të tyre. KKP-ja do të ftojë një numër të duhur të ekspertëve në mbledhjet e veta.

Këshilli Kombëtar i Pagesave synon të mbështetë arritjen e sistemeve të qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave

me vlerë në Kosovë. Ai gjithashtu mund të shërbejë si një forum për bashkëpunim për sigurimin e kushteve të duhura në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare të pagesave. Në kuadër të KKP-së funksionon grupi i veçantë i punës për promovimin e pagesave pa para të gatshme. Objektivi parësor i grupit është për të përgatitur kodin e mirësjelljes dhe rregullat për veprimet dhe masat që duhen ndërmarrë nga bankat, komuniteti i biznesit dhe individët privat për reduktimin e vëllimit të transaksioneve në para të gatshme.

1.3. Roli i organeve të tjera publike dhe private

1.3.1. Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

Shoqata e Bankave të Kosovës është një organizatë përfaqësuese e pavarur e themeluar në vitin 2003 nga ana e bankave komerciale që operojnë në Kosovë. SHBK aktualisht ka nëntë (9) anëtarë. Kjo organizatë vepron si zëri i sektorit bankar dhe si një forum ku bankat mund të debatojnë çështje të ndryshme para se t'i diskutojnë ato me BQK-në apo institucionet e tjera. SHBK gjithashtu kryen programe intensive trajnimi për sektorin bankar.

1.4. Ndërmjetësit financiarë që ofrojnë shërbime pagesash

1.4.1. Bankat

Bankat komerciale në Kosovë janë banka universale, prandaj kryejnë një gamë të gjerë aktivitetesh bankare. Legjislacioni aktual nuk bën dallim në mes të bankave komerciale, kursimeve, hipotekare dhe bankave kooperative. Në Kosovë të gjitha bankat kanë të drejtën për të ofruar të gjitha llojet e shërbimeve bankare, duke përfshirë këtu edhe llojet e ndryshme të shërbimeve të pagesave, depozitave, kredive dhe këmbimeve valutore.

Çdo bankë përcakton çmimet dhe tarifrat e aplikueshme për klientët e vet, në pajtim me politikat e veta, pa kufizime ligjore. Po ashtu nuk ka kufizime sa i përket numrit të degëve të bankave.

1.4.2. Institucionet Mikrofinanciare

Institucionet Mikrofinanciare (IMF) janë institucione financiare, aktiviteti i të cilave zakonisht është kreditimi në vlera të vogla. Këto institucione japin kredi të vogla individuale dhe kredi për biznese të vogla, qofshin ato në sektorin e bujqësisë, prodhimtarisë apo shërbimeve.

IMF-të rregullohen sipas Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare . Aktualisht në Kosovë janë të licencuara katërbëdhjetë (14) institucione mikrofinanciare.

1.4.3. Agjensionet për Transfer Parash

Ashtu siç tregon edhe emri, këto institucione kanë si aktivitet transferimin e parave. Transferimi i parave bëhet si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si transfere hyrëse apo dalëse. Aktualisht janë të licencuara shtatë (7) agjencione për transfer parash . Agjensionet rregullohen sipas rregullës për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e institucioneve financiare jobankare të cilat veprojnë në Kosovë.

2. Instrumentet e pagesave që përdoren në Kosovë

2.1. Pagesat në para të gatshme

Valuta e përdorur në Kosovë është euro. Seria e kartëmonedhave në qarkullim përfshin shtatë denominime të ndryshme me vlera: 5 €, 10 €, 20 €, 50 €, 100 €, 200 € dhe 500 €. Monedhat euro në qarkullim janë: 1, 2, 5, 20 dhe 50 cent, si dhe 1 € dhe 2 €.

Një nga detyrat e BQK-së sipas Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, është të bëjë “sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë”. Kosova nuk është anëtare e eurozonës, prandaj në mënyrë që të përmbushë detyrën e saj në lidhje me paranë e gatshme, ajo importon monedhat dhe kartëmonedhat nga eurozona. BQK-ja iu ofron shërbime depozituese dhe tërheqjeje në para të gatshme klientëve të saj, të cilat janë kryesisht banka komerciale. Ka një kërkesë më të madhe për kartëmonedhat me vlera të vogla, kryesisht për shkak se ato përdoren në ATM-të e bankave komerciale dhe shpejt dëmtohen fizikisht.

Kërkesa për para të gatshme nga ana e sektorit jobankar është rritur nominalisht gjatë viteve të fundit; por efektet sezonale shkaktojnë luhajtje të konsiderueshme në përdorimin e parave të gatshme gjatë vitit. Mbajtja e parasë së gatshme nga publiku ndryshon dukshëm brenda muajit (në rritje në ditët që paguhen pensionet, pagat, etj.), dhe brenda vitit (qarkullimi i parasë së gatshme rritet shumë gjatë periudhës së verës dhe në fund të vitit, ndërsa zvogëlohet dukshëm në fillim të vitit dhe gjatë stinës së vjeshtës). Luhajtjet brenda vitit mund të shpjegohen nga fluksi i emigrantëve që vizitojnë Kosovën gjatë intervaleve të ndryshme të vitit.

Edhe pse instrumentet e reja të pagesave janë ofruar nga sektori bankar, sistemi i pagesave në Kosovë karakterizohet me një mbështetje të vazhdueshme të qytetarëve në pagesat me para të gatshme.

Me përjashtim të pagesave kos-giro (një pjesë e madhe e të cilave paguhen në para të gatshme), shumica e pagesave ndërbankare përmes SPN-së iniciohen nga institucionet qeveritare apo nga entitetet komerciale.

2.2. Pagesat pa përdorimin e parasë së gatshme

2.2.1. Transferet e kreditit

Transferet e kreditit janë forma më dominuese e pagesave pa para të gatshme në Republikën e Kosovës. Këto pagesa bëhen nga konsumatorët në bankat e tyre apo shërbimeve që i ofrohen nga ato, përmes urdhërpagesave elektronike apo atyre në formë letër. Një urdhër pagesë letër e përdorur shumë në Kosovë është kos-giro, e cila u krijua për të rritur efikasitetin e pagesave në formë letër për të gjitha palët e përfshira: bankat, konsumatorët dhe kompanitë (si publike ashtu edhe private). Te këto urdhërpagesa speciale, kompanitë faturuese si psh. kompanitë e shërbimeve utilitare përfshijnë një formular të standardizuar të pagesave në fund të çdo fature që iu dërgojnë konsumatorëve të tyre. Këto fatura të standardizuara përmbajnë në vete të dhëna mbi pagesën në barkodin e shtypur, i cili skanohet lehtësisht nga barkod lexuesi i bankave. Pas skenimit të faturës, pagesa procesohet automatikisht nga ana e bankës.

Gjatë viteve të fundit, e-bankingu është rritur me shpejtësi. Bankat kanë filluar të inkurajojnë përdorimin e pagesave elektronike nga konsumatorët e tyre dhe të konkurrojnë me njëra-tjetrën në ofrimin e shërbimeve të tilla.

2.2.2. Debitimi Direkt

Debitimi direkt është prezantuar për përdorim për publikun në nëntor 2009. Ky është një instrument i ri i pagesave, prandaj akoma nuk përdoret në atë masë sa instrumentet e tjera të pagesave. Kompanitë më të mëdha utilitare i janë bashkuar skemës së debitimit direkt.

Pavarësisht se numri dhe vlera e këtyre pagesave po rritet nga viti në vit, numri i llogarive të lidhura me debitim direkt akoma mbetet i ulët dhe nevojitet angazhim më i madh i të gjithë pjesëmarrësve në sistemin financiar, në mënyrë që të rritet numri i tyre, me qëllim zvogëlimin e pagesave me para të gatshme.

2.2.4. Kartelat me funksion pagese

Gjatë viteve të fundit, numri i kartelave me funksion pagese është rritur dukshëm. Shumica e qytetarëve që kanë një llogari bankare, kanë zakonisht edhe një kartelë me funksion pagese. Shumica e kartelave të pagesave të lëshuara nga bankat janë të markës Visa apo MasterCard. Rrjeti i ATM-ve dhe POS-ve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje, edhe pse ndërveprimi i rrjeteve të bankave në mes njëra-tjetrës nuk është i kënaqshëm.

Kartelat e Debitit

Kartelat e debitit janë kartelat më të shumta në numër në Kosovë. Kartelat e markës Visa dominojnë tregun. Kartelat e debitit të lëshuara nga bankat komerciale mund të përdoren në ATM dhe POS terminale si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj. Në fund të vitit 2016 numri i kartelave të debitit arriti në 856,718, që krahasuar me vitin 2015 paraqet rritje prej rreth 19.2 për qind.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna më të detajuara mbi numrin e kartelave të debitit nga viti 2012 deri në vitin 2016, nga ku mund të konstatohet mbi rritjen e numrit të tyre çdo vit.

Tabela 1. Numri i kartelave të debitit

Tipi	2012	2013	2014	2015	2016
VISA	437,304	484,300	496,319	494,077	662,364
MasterCard	135,995	159,959	181,517	180,449	174,607
Kartela lokale	26,072	789	254	44,191	19,747
Gjithsej	599,371	645,048	678,090	718,717	856,718

Kartelat e Kreditit

Numri i kartelave të kreditit është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Bankat komerciale që operojnë në Kosovë i kanë kushtuar vëmendje të shtuar rritjes së numrit të kredit kartelave në vend. Në fund të vitit 2016, numri i kredit kartelave arriti në 156,437 që krahasuar me vitin 2015 paraqet rritje prej rreth 8.74 për qind. Shumica e kartelave janë të markës Visa apo MasterCard.

Në tabelën numër 2 janë paraqitur të dhëna për numrin e kartelave të kreditit duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2016. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të shihet rritja e numrit të tyre çdo vit.

Tabela 2. Numri i kartelave të kreditit

Tipi	2012	2013	2014	2015	2016
VISA	83,188	96,976	110,611	128,397	136,387
MasterCard	12,754	12,356	11,041	12,993	18,813
Kartela lokale	0	0	0	2,473	1,237
Gjithsej	95,942	109,332	121,652	143,863	156,437

Prepaid Kartelat

Deri më sot, vetëm një bankë ka lëshuar kartelë prepaid debiti në Kosovë. Kjo kartelë është nxjerrë në bashkëpunim me një kompani të telekomunikacionit.

2.2.5. E-Banking

Pothuajse të gjitha bankat në Kosovë ofrojnë shërbimin e-Banking për klientët e tyre. Me këtë shërbim, klientët mund t'i qasen llogarisë së tyre dhe të iniciojnë transfere, përmes kompjuterëve personal (PC) të kyçur në internet. Numri dhe vlera e transfereve E-Banking është në rritje të vazhdueshme. Vlen të theksohet se përdorimi i këtij shërbimi është rritur shpejt kohëve të fundit.

Për ta pasur më të qartë rritjen e numrit dhe vlerës së pagesave të realizuara me shërbimin E-Banking, në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna statistikore për këtë shërbim duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2016. Duhet theksuar se në vitet e fundit pagesat me e-banking kanë pasur trend të lart të rritjes.

Tabela 4. Pagesat e realizuara me E-Banking

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i transaksioneve	625,762	1,056,655	1,579,838	2,311,564	2,915,082
Vlera e transaksioneve	1,499,093,438	2,671,011,546	4,220,405,696	5,746,325,675.39	6,703,386,853

2.3. Zhvillimet e reja

Kohëve të fundit në tregun e shërbimeve të pagesave ka filluar të rritet interesimi për pagesat përmes telefonit (mobile banking). Këto shërbime i mundësojnë konsumatorit të kryejë pagesa të ndryshme përmes telefonit celular në çdo kohë në tërë territorin e Kosovës. Duke pasur parasysh penetrimin e lartë të telefonave mobilë tek qytetarët e Kosovës, dhe

mbulueshmërinë e pothuajse të gjithë vendit nga operatorët e telekomit, kjo mënyrë e kryerjes së pagesave duket mjaft premtuese në të ardhmen. Për momentin disa banka janë në fazën fillestare të ofrimit të këtij shërbimi.

Paraqitja e ATM terminaleve me barkod lexues do të rritë efikasitetin e shërbimeve të pagesave, dhe sidomos të pagesave kos giro. Përmes këtyre terminaleve konsumatori pa pasur nevojë të shkojë në degë të bankave mund të paguajë faturat e kompanive publike e private (si KEDS, PTK, etj.). Përveç komoditetit dhe shpejtësisë, ky zhvillim do të zvogëlojë shpenzimet administrative të bankave komerciale, si dhe do të nxitë pagesën e këtyre faturave përmes llogarive bankare dhe parave jo të gatshme.

3. Sistemi i kliringut dhe shlyerjes ndërbankare

3.1. Sistemi i Pagesave Ndërbankare

BQK-ja operon sistemin e vetëm të pagesave ndërbankare në Kosovë. Ky sistem i pagesave ndërbankare, i quajtur ATS (automatic transfer system) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement) i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël.




Figura 1. Sistemi aktual i Kliringut dhe Shlyerjes Ndërbankare

Të gjitha bankat komerciale janë pjesëmarrëse në SPN, po ashtu edhe BQK-ja (në emër të vet dhe të Qeverisë). Bankat komerciale janë të lidhura me

SPN përmes fijeve optike që zëvendësojnë linjat e huazuara (të cilat do të shfrytëzohen si komunikim rezervë).

3.1.1. Rregullat dhe Procedurat

BQK-ja ka miratuar të gjitha rregullat dhe procedurat e nevojshme të SPN-së. Ato janë ligjërisht të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Rregullat dhe procedurat përcaktojnë orarin e operacioneve të sistemit, procedurat e kliringut dhe shlyerjes, përgjegjësitë e pjesëmarrësve, përgjegjësitë e BQK-së, kërkesat teknike që duhet plotësuar nga pjesëmarrësit, si dhe përcakton finalizimin, pakthyeshmërinë dhe pandryshueshmërinë e transaksioneve në llogaritë e shlyerjes. Përmbajtja e pjesëmarrësve në sistem me këto akte është e detyrueshme.

Standardi i mesazheve dhe procedurat për siguri janë përgatitur nga BQK-ja, dhe pjesëmarrësit në sistem janë të obliguar t'i përfillin ato. SPN-ja përdor forma standarde të mesazheve të cilat janë zhvilluar gjatë krijimit të SPN-së, dhe janë sipas standardeve ndërkombëtare.

3.1.2. Pjesëmarrja në sistemin SPN

Qasja në SPN përcaktohet sipas rregullave dhe procedurave të SPN-së, dhe kushteve të tjera publike të miratuara nga BQK-ja. Të gjitha këto akte që përcaktojnë kriteret mbi qasjen në SPN janë dokumente publike.

Kriteret për qasje kërkojnë që pjesëmarrësit të kenë resurse të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe organizative për operacionet në kushte normale dhe ato emergjente.

Aktualisht janë njëmbëdhjetë (11) pjesëmarrës direkt në SPN. Kjo përfshin dhjetë (10) banka komerciale dhe BQK-në (në emër të vet dhe të Qeverisë). Të gjitha bankat e licencuara në Kosovë marrin pjesë në SPN. Institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, etj. mbajnë llogari bankare të pjesëmarrësit direkt, të cilët veprojnë si agjentë të tyre të pagesave.

3.1.3. Llojet e transaksioneve të SPN-së

SPN-ja përdoret për pagesat ndërbankare me vlerë të vogël (nën 10,000 €) dhe ato me vlerë të madhe (mbi 10,000 €). Ky sistem kryen kliringun e të gjitha pagesave RTGS dhe atyre prioritare, si dhe pagesave me vlerë të vogël përmes ACH-së që përfshijnë: pagesave individuale, pagesave me shumicë, pagesave kos-giro, dhe pagesat e debitimit direkt.

Pagesat RTGS dhe pagesat prioritare

Pagesat RTGS dhe ato prioritare mund të iniciohen në çdo kohë gjatë ditëve të punës të SPN-së dhe të cilat duhet të procesohen menjëherë nga SPN-ja në baza bruto, në çdo rast brenda 15 minutash pas pranimit të pagesës. Pagesat përmes RTGS-së përfshijnë: pagesat e klientëve, pagesat mes bankave dhe letrat me vlerë.

Procesi i vonuar i shlyerjes për pagesat prioritare paraqet një rrezik sistemik dhe të shlyerjes, që për momentin niveli aktual i rrezikut duket më i vogël për shkak të nivelit të lartë të likuiditetit në ekonomi. Vëllimi i pagesave RTGS dhe prioritare është i ulët por si vlerë ato përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të pagesave.

Pagesat RTGS dhe ato prioritare janë pagesa të cilat kryesisht kanë vlera të mëdha (mbi 10,000 €) dhe duhet të procesohen për një periudhë të shkurtër kohore.

Tabela 6. Numri dhe vlera e pagesave prioritare

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i transaksioneve	22,300	24,812	26,079	28,645	69,389
Vlera e transaksioneve	893,490,615	768,577,986	666,722,026	712,772,611	5,581,140,123

Pagesat individuale

Pagesat individuale janë transfere individuale krediti të cilat zakonisht iniciohen në një degë të bankës nga paguesi përmes një urdhërpagese në formë letër. Kjo urdhërpagesë futet në sistemin qendror të bankës komerciale dhe më vonë dërgohet për kliring në SPN. Paguesi ose paguan me para të gatshme ose me mjetet nga llogaria e tij bankare. Ky instrument është përgjithësisht analog me transferet e kreditit, ashtu siç përkufizohet nga BIS/CPSS.

Për nga numri, pagesat e rregullta janë ndër pjesëmarrësit kryesor në SPN. Në vitin 2016, pagesat e rregullta individuale përbëjnë 11.24 për qind të numrit të përgjithshëm të pagesave të SPN-së ndërsa në vlerën e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare ato marrin pjesë me 22.68 për qind.

Tabela 5. Numri dhe vlera e pagesave të rregullta

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i transaksioneve	833,409	970,717	1,032,043	1,210,355	1,303,683
Vlera e transaksioneve	3,161,880,010	3,319,527,253	3,329,886,961	3,677,815,746	2,416,603,204

Pagesat me shumicë (masive)

Këto pagesa mund të përdoren për pagesat një-për-shumë (për shembull pagesat e rrogave) ose shumë-për-një (të cilat kryesisht përdoren për konsolidimin e taksave qeveritare dhe të ardhurave doganore para se t'i përcillen BQK-së nga bankat komerciale). Gjatë çdo sesioni të kliringut, SPN-ja ndan pagesat një-për-shumë, dhe konsolidon pagesat shumë-për-një, në pagesa individuale të cilat më pastaj procesohen. Pothuajse të gjitha pagesat me shumicë bëhen nga ose për institucionet qeveritare. BQK-ja dëshiron të nxitë sektorin privat të përdorin më shumë këtë lloj të pagesave, si psh. për pagesat e rrogave, etj.

Pagesat e rregullta masive përbëjnë rreth 35.25 për qind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve të SPN-së, ndërsa vlera e tyre merr pjesë me 6.18 për qind në vlerën e transaksioneve.

Tabela 7. Numri dhe vlera e pagesave masive

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i transaksioneve	2,916,145	3,294,677	3,731,436	3,766,942	4,087,636
Vlera e transaksioneve	470,361,458	531,795,573	536,499,429	595,030,788	658,485,414

Kos-Giro

Ky instrument dhe kjo skemë e pagesave është finalizuar në vitin 2005 si një mënyrë më efikase me të cilën konsumatorët mund të paguajnë faturat. Sipas skemës, faturuesit si psh. kompanitë e shërbimeve publike, etj. përfshijnë një formular të standardizuar të pagesave në fund të çdo fature që iu dërgojnë konsumatorëve të tyre. Këto fatura të standardizuara përmbajnë në vete të dhëna mbi pagesën në barkodin e shtypur, i cili skanohet lehtësisht nga barkod lexuesi i bankave. Pas skenimit të faturës, pagesa procesohet automatikisht nga ana e bankës. Së pari futet në sistemin qendror të bankës komerciale dhe më pas procesohen në SPN për kliring. Konsumatori ose paguan me para të gatshme ose me mjetet nga llogaria e tij bankare.

Kos giro është një tjetër formë e transferit individual të kreditit. Përdorimi i kos-giros ka shënuar një rritje të qëndrueshme që prej fillimit të saj. Numri dhe vlera e pagesave kos-giro është shumëfishuar gjatë viteve. Kjo rritje është bërë në saje të bashkëngjitjes në skemën e kos giros të 16 kompanive dhe agjencive, si Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), shërbimit doganor, etj.

Pagesat kos giro vazhdojnë të jenë pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të pagesave: numri i tyre përbën 12.19 për qind të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën 10.76 për qind të vlerës së transaksioneve ndërbankare.

Tabela 8. Numri dhe vlera e pagesave Kos Giro

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	
Numri i transaksioneve	543,338	692,281	1,013,620	1,349,316	1,413,616
Vlera e transaksioneve	892,130,913	899,986,956	949,316,256	1,048,213,712	1,145,873,024

Debitimi Direkt

Debitimi direkt është prezantuar për përdorim nga publiku në nëntor 2009. Ky është një instrument i ri i pagesave, prandaj akoma nuk përdoret në atë masë sa instrumentet e tjera të pagesave. Kompanitë më të mëdha publike i janë bashkuar skemës së debitimit direkt.

Me gjithë rritjen e vazhdueshme të numrit të pagesave përmes kësaj skeme, debitimi direkt akoma mbetet pak i përdorur në Kosovë. Debitimi direkt merr pjesë me më pak se 1%, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve ndërbankare.

Tabela 9. Numri dhe vlera e pagesave të debitimit direkt

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	
Numri i transaksioneve	10,304	13,115	14,582	15,565	26,610
Vlera e transaksioneve	8,043,429	6,763,903	7,182,931	7,152,037	8,568,652

3.1.4. Orari i punës

Orari i punës i SPN-së është aprovuar nga menaxhmenti i BQK-së në bashkëpunim të ngushtë me sektorin bankar. Aktualisht orari i punës është prej 8:00 deri 15:45 për çdo ditë pune. Për festat zyrtare SPN-ja është i mbyllur.

Orari në fund të ditës së punës mund të ndryshojë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme në pajtim me rregullat dhe standardet e SPN-së, dhe vetëm me miratim të BQK-së si operatore e sistemit.

3.1.5. Tarifat dhe çmimet

BQK-ja si pronare dhe operatore e SPN-së, ka vendosur tarifën për ofrimin e shërbimeve të pagesave që ofron ky sistem. Këto tarifa kategorizohen në

këto kategori të mëposhtme: tarifa për kyçje për pjesëmarrës të ri, tarifa mujore për mirëmbajtje të lidhjes telekomunikuese, tarifa për raporte të veçanta, dhe tarifa për transaksione.

Çmimi për një transaksion ndryshon varësisht nga lloji i pagesës dhe sesioni që kryhet kliringu: çmimet janë më të larta për sesionet e paradites, ndërsa më të ulëta për sesionet e pasdites. Pagesat RTGS/prioritare shlyhen një nga një në baza bruto, jo më vonë se 15 minuta pas pranimit të tyre, nga ora 8:00 deri në ora 15:45.

Ka tarifa për kyçje për pjesëmarrës të ri, por nuk ka tarifa vjetore anëtarësimi për pjesëmarrësit ekzistues. Pjesëmarrësit paguajnë çdo muaj një tarifë minimale për mirëmbajtje të lidhjes telekomunikuese.

Politika e BQK-së për vendosjen e çmimeve për shërbimet e SPN-së bazohet në parimin e kthimit të plotë të shpenzimeve, pra qëllimi nuk është profiti. Tarifat shqyrtohen kohë pas kohe nga BQK-ja në bazë të kësaj politike. Në këtë mënyrë BQK-ja synon të ndihmojë sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi, duke ofruar tarifa të ulëta që promovojnë përdorimin e instrumenteve e pagesave në para jo të gatshme.

3.2. Informata Statistikore

Gjatë vitit 2016 rreth 11.6 milionë transaksione me vlerë të përgjithshme prej 10.7 miliardë euro u kanalizuan përmes SPN-së. Krahasuar me transaksionet e SPN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 17.88 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 42.52 për qind

Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve të SPN-së në vitin 2016 ishte 42.8 milionë euro, krahasuar me rreth 30.14 milionë euro në vitin 2015.